



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly of Rahovec

-III-

Nr. prot. 2685

Dt. 26.09.2018

1

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **31.08.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. **Kryesuesi** – Përsëritet për kryetarin e komunës z. Smajl Latfi, nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i informatës së qarkores buxhetor për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit paraparak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores për shërbime publike,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për mbështetje financiare për Festivalin Tradicional “Festa e vjeljes së rrushit – 7 shtatori”.

Kryesuesi – A ka dish të shtoj diçka sa i përket këtij rendi të ditës, nëse jo atëherë e qesim në votim rendin e ditës: Konstatohet se me vota unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rasim Fazliu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, e di se sekretaria e kuvendit kanë punë voluminoze prandaj edhe bëhen lëshime ose gabime teknike ndonjëherë, kuptohet pa dashje, është bërë një gabim teknik në faqe nr. 10 tek diskutimi në vend se të thuhet rënie është shkruar rrënje, vetëm kjo le të përmirësohet asgjë më shumë.

Kryesuesi – A ka dikush tjetër ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket pikës së parë të rendit të ditës. Nëse jo atëherë e qes në aprovim Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi – A ka ndonjëri nga drejtorët që ka mbetur pa ju përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin, fjalën e keni ju kuvendarë nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Rexhep Oruçi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, desha të ngris një çështje rreth një kërkese të cilën e ka bërë z. Nazim Veliu për ti dalë në ndihmë, për arsye se gruaja i vuan nga një sëmundje shumë e rëndë, ka 1 vit që është duke u shëruar. Gjendja e saj tani për tani është shumë e rëndë, prandaj aji ju është drejtuar

me kërkesë edhe Kuvendit të komunës, dhe kryetarit të komunës, prandaj mendoj se është dashur që kjo kërkesë të jetë si pikë e rendit të ditës, edhe nëse kishte me marr përgjigje negative është në rregull, por është dashur të shqyrtohet nga kuvendarët. Kryetari ka mundur edhe mos me ja dhënë përgjigje në kërkesën që ju është drejtuar atij, por kuvendi është dashur që ti jepe një përgjigje. Personi në fjalë kërkesën e ka të protokolluar që nga data 17 korrik 2018, ne jemi të obliguar që brenda një muaji të ja kthejmë një përgjigje ose pozitive ose negative.

Rasim Fazliu – Do e ngris një shqetësim të qytetarëve të komunës së Rahovecit edhe pse kjo është më tepër si propozim, disa rrugë lokale në të cilët edhe ne jemi duke i frekuentuar çdo ditë janë të zënë me degë të drunjëve dhe me këtë me të vërtetë është duke u rrezikuar jeta e kalimtarëve si me makina ashtu edhe pa makina. Konkretisht fjalën e kam rruga e cila e lidhë fshatin Celin me Krushe, tani vetëm sa nuk ka filluar viti shkollor dhe kjo rrugë me të vërtetë është shumë e rrezikshme, prandaj e lusë drejtorin përkatëse që të bëjë krasitjen e degëve në mënyrë që të bëhet rruga e kalueshme.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, këtë pyetje e kam parashtruar edhe më herët, por kam marr një përgjigje e cila nuk më ka kënaqur prandaj dua që të përsërisë edhe një herë këtë pyetje: Çka është duke ndodhur me ujin e pijes për fshatin Polluzh dhe fshatrat tjerë të kësaj ane. Ka shumë vërejtje dhe shumë pyetje për të cilat ne duhet që të kemi përgjigje.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e di që ka qenë një komision për emërtimin e rrugëve, desha ta di ky komision a është ende valid, nëse jo atëherë si është e mundur që ne ta krijojmë një komision për emërtimin e rrugëve, sepse ka disa rrugë të reja që kanë nevojë që të emërtohen.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha ta ngris një shqetësim të qytetarëve rreth orarit të punë së barnatoreve humane, me theks të veçantë në qytet të cilat nuk ofrojnë kujdestari gjatë natës. Qytetarët e komunës sonë janë të obliguar që të shkojnë në qendra më të mëdha qoftë në Gjakovë apo Prizren edhe për barëra më elementare, kuvendi komunal në vitin 2011 e ka nxjerrë një rregullore me të cilën rregullohet orari i punës të organizatave bizneseve të cilat operojnë në komunën e Rahovecit, qoftë gjatë orarit të natës ose gjatë festave zyrtare, por siç po shihet kjo rregullore nuk është duke gjetur zbatim nga barnaret të cilat operojnë afër QKMF –së në Rahovec. Kërkoj nga drejtorja e shëndetësisë që të ja caktojë një orar të kujdestarisë gjatë natës, po ashtu të bëhet inspektimi për respektim të këtij orari, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje për të i kryer këto shërbime.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ngris një shqetësim që nuk është vetëm i imi por është shqetësim i një lagje të tërë, pra bëhet fjalë për lagjen nr.5, është një krrua publik shumë i vjetër në qendër të kësaj lagje, ky krrua është shfrytëzuar nga qytetarët e kësaj pjese, por ky krrua këtë vit nuk ka fare ujë, shqetësimi i qytetarëve është se mos është bërë ndonjë keqpërdorim, mos dikush e ka kthyer këtë ujë për vete për nevojat personale. Këtë shqetësim qytetarët e kanë paraqitur në debatin për dëgjime publike që e kemi pasur për buxhetin e vitit 2019. Mendoj se këtu duhet që të ndërhyhet në mënyrë që uji të kthehet në vendin ku ka rrjedhur gjithmonë.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një shqetësim sepse ne qytetarët e kësaj komune nuk jemi aq të pasur që taksat tona të shkojnë pa pasur nevojë. Ka dy muaj e gjysmë që dritat e ndriçimit publik në fshatin Celin dhe Krushe të Madhe qëndrojnë të ndezura 24 orë, mendoj se drejtorja përkatëse duhet që sa ma shpejtë të ndërmer masa që të rregullojë këtë problem.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë, po ju përcjelli një shqetësim nga banorët e fshatit Brestoc, në rrugën Dituria është një prockë, dhe sa herë që kemi reshje të shiut uji del nga kjo prockë, ku më pas shkakton shumë dëme për banorët e kësaj lagje, shumica prej banorëve janë të komunitetit jo shumicë. Propozoj që kjo prockë të pari të pastrohet nga mbeturinat e pastaj të thellohet.

Besmira Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e ngris një çështje të banorëve të komunës së Rahovecit, besoj se edhe kryetari e ka parë sot se në çfarë gjendje ka qenë hapësira para banesave ku jetojmë unë dhe kryetari nga kompania e cila e ka fituar tenderit për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara. Të nderuar kjo nuk është hera e parë por as e dyta, kjo kompani çdo herë kur bënë pastrimin e

hapësirave të gjelbëruara e lënë në atë mënyrë qysh e kam parë unë dhe kryetari. Mendoj se duhet që të mirën masat ndaj kësaj kompanie që herrave të tjera të mos e bëjë ashtu punën, kompania ambienti e ka bërë pastaj pastrimin e asaj hapësire edhe pse ajo nuk e ka për detyrë që të bëjë atë. Çështje tjetër ka të bëjë sa i përket zyrave të vendit të komunës së Rahovecit, nëse shkon për ta nxjerrë një dokument si p.sh certifikatën e lindjes ata ja kërkojnë vërtetimin që e kanë të paguar tatimin në pronë, për të mare këtë vërtetim duhet qytetari të vijë në qytet pra në Rahovec, prandaj konsideroj se duhet që të kenë një sistem online dhe të kenë qasje edhe zyrat e vendit që të shikojnë online nëse pala e ka të paguar ose nuk e ka të paguar tatimin në pronë. Kam edhe një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, javën e kaluar në QKMF kishte shumë pacientë, ndërsa infermieret nuk lëviznin nga vendi të, pra askush nuk e kryenin punën e tyre, është dashur 3 herë të shkoj dhe të ju them se duhet që të kryenin shërbimet ndaj pacientëve sepse janë duke u paguar për këtë punë, shpresoj se drejtori i shëndetësisë së bashku me kryetarin e komunës do të ndërmarrin shumë shpejtë masa.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua ta ngris një çështje me kërkesë të disa qytetarëve për arsye se disa hoteleri nuk e respektojnë orarin e punës, sidomos gjatë natës ata lëshojnë muzikë me zë të lartë dhe kjo i pengon dhe i shqetëson qytetarët. Pra këtu bëhet fjalë për thyerje të një dispozite ligjore e cila precizon që muzika në lokale mundet të lëshohet derti në ora 23:00, ndërsa tek këto lokale është duke vazhduar deri ora 02:00. Qytetarët shumë herë e kanë lajmëruar policin e Kosovës, ku kanë marrë përgjigje negative, sepse sipas tyre kjo është përgjegjësi e inspektoratit komunal, dhe ata i kanë pajisjet për matje të nivelit të zërit, po ashtu ata e kanë të drejtën e shqiptimit të gjobave për ata të cilët i thyejnë këto rregulla. Kërkoj nga drejtori i inspektoratit që të më përgjigjë rreth kësaj, pastaj a kanë dalë në teren për të vizituar këto lokale, po ashtu a kemi një plan për të ja siguruar qytetarëve një qetësi gjatë natës ashtu siç është me ligj.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, derisa kolegu z. Faton Ramadani u ankua se fshati Celin dhe Krushe e Madhe kanë 24 orë ndriçim publik, në fshatin Fortesë është e kundërta, ka disa javë që fshati Fortesë ka probleme me ndriçim publik, prandaj kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike që të ndërmerr masa dhe ti evitojë këto probleme. Po ashtu desha të ndërlihem edhe me kërkesën që e bëri z. Rexhep Oruçi rreth mbështetjes së pacientëve me ndihma financiare, por dikush për shkak të mos informimit që bëhet ndihma nga ana e komunës nuk mundet të përfitoj edhe pse ka shumë nevojë. Por nëse në vazhdimësi na paraqiten kërkesat e tilla, dhe nëse komuna ka mjete financiare për të dalë në ndihmë kësaj kategorie, kishte me qenë mirë që të formohet një grup i cili do ti evidentonte pacientët të cilët kanë nevojë që ti ndihmohet, e mos të shkohet në formon që është duke shkuar deri më tani, që dikush të ndihmohet për arsye se e ka një lidhje familjare me dike që është në pushtet, mendoj që kjo nuk është fare e drejtë dhe nuk është në të mirën e qytetarëve.

Refki Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për drejtorin e shëndetësisë, në qendrën e mjekësisë familjare në fshatin Xërxë gjendja nuk është aspak e mirë e mos të themi edhe kaotike, ka erë të rëndë, mykë në mure, fasadë të dëmtuar, mungesë të pastrueseve. Ajo që dua të them është kjo: A e konsideron të arsyeshme që të dalësh në teren që ti vizitosh këto qendra, apo duhet që të presësh në zyrën tënde mediat që të marrin në intervistë rreth gjendjes së krijuar në qendrën e mjekësisë familjare. Po ashtu e kam edhe një pyetje për kryetarin e komunës, i nderuar këto ditë të fundit kemi marrë një lajm shumë të mirë nga Ministria e Infrastrukturës rreth rregullimit të autostradës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë- Prizren, ajo që i shqetëson banorët e fshatit Xërxë është kjo: A do të kalojë autostrada në trasenë ekzistuese, apo do të ndërtohet ndonjë trase e re në periferi të fshatit Xërxë, kah Ura e Shehtë përgjatë Drinit të bardhë, deri tek Rugova e Hasit dhe tutje. Propozimi imë është që ju si kryetar i komunës kishte me qenë mirë që të kontaktoni me njerëzit kompetentë të cilat janë në Ministrinë përkatëse, po ashtu është mirë që të organizoni një debat publik me banorët e fshatit dhe përfaqësuesit të bizneseve, me temën e dy alternativave të ndërtimit të kësaj autostrade e cila kalon përmes fshatit Xërxë.

Mirjeta Krasniqi - Përsëritje për të gjithë të pranishmit, kamë pasur shumë pyetje nga qytetarët e ndryshëm se kur do të fillojë shpërndarja e mjeteve për dëmet që janë shkaktuar nga të reshurat e fundit, po ashtu a është caktuar shuma për ndarjen e mjeteve për komunën e Rahovecit.

Kryetari – Përsëritje për të gjithë të pranishmit në sallë, mendoj se është një kontribut i mirë të gjitha këto pyetje dhe këto shqetësime që i keni adresuar në këtë seancë, do ja filloj me iu përgjigje pyetje me radhë: I nderuari z. Rexhep Oruçi, çdo kërkesë e cila i drejtohet organeve komunale merë përgjigje sipas ligjit brenda një muaji, i nderuar jam në dijeni për rastin që e ka z. Velu, por po ju them se kjo kërkesë ka marrë përgjigje pozitive para një jave. Ndërsa sa i përket shqetësimit që e ngrii z. Ali Zhuniqi, i nderuar është një komision i formuar në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë, i cili administron, trajton, vlerëson dhe jep propozime rreth përmbushjes ose jo për ndihmë momentale, që zakonisht janë rastet e familjes në nevojë dhe sëmundje të ndryshme. Ne sidomos sëmundjet e rënda si ato kancerogjene jemi duke u përpjekur që të i trajtojmë me kujdes, po ashtu ne do të kishim dëshirë që përgjigjet tona në këto raste të jenë sa më pozitive. Sa i përket pyetjes së z. Rasim Fazliu, i nderuar është fati i mirë që ne tani kemi lidhur një kontratë por nuk e di a e ka të paraparë këtë pozicion, por ne do e lusim operatorin që ti pastroj brezalet të cilat kanë dalur në rrugë, po ashtu ne do ta shfrytëzojmë edhe një të drejtë, punëtorët që janë të punësuar si punëtor sezonal për mirëmbajtjen e hapësirave publike do të kërkojmë edhe ndihmë prej tyre që aq sa munden të e bëjnë edhe krasitjen e këtyre brezareve. Mundeni të shikoni rrugës për në Senoc në fshatin Polluzhë punëtori sezonal që është i punësuar është duke i prerë këto drunjë që kanë dalur në rrugë, pra është duke e liruar rrugën. Kishte edhe një pyetje sa i përket ujit të pijes në fshatin Pollzhë, i nderuar sot do të nënshkruhet kontrata me kompaninë KRU – Gjakova, ata i kanë zhvilluar procedurat dhe shpresojmë se jo më larg se ditën e hënë do të fillojnë aktivitetet faktike në teren. Menaxhimin e gjithë këtij procesi e ka bërë KRU- Gjakova, është e vërtetë që ka pasur vonesa por këto janë çështje të prokurimit, ne shpresojmë se kjo punë do të kryhet shumë shpejtë, pasi ata e dinë gjendjen faktike. Ne nuk e dimë ende vlerën e kontratës, por ajo që e di është se komplet dokumentacioni i cili është kërkuar nga ne ju është ofruar. Me zgjidhjen e problemit të ujit të pijes në fshatin Polluzhë dhe Guri të Kuq, pastaj na hapet mundësia që të zgjidhim problemin edhe për fshatin Pastasel. Partecipimi i komunës është 49%, por procedurat i zhvillon KRU – Gjakova, por duhet që ta dini se sipas KRU- Gjakovës kjo për këtë vit nuk ka qenë e planifikuar, por ne kemi insistuar tek ta për zgjidhje sa më të shpejtë për shkak të problemit shumë vjeçar, dhe të i jepet fundi sa ma shpejtë këtij problemi. Sa i përket orarit të farmacive, i nderuar është e vërtetë që ka një rregullore për respektim të orarit të farmacive, e cila është aprovuar në vitin 2011, ndoshta 2-3 muaj ka pasur përmirësime sa i përket respektimit të kësaj rregullore, por më vonë më kurë nuk është zbatuar orari i kujdestarisë, për këtë shqetësim ne kemi biseduar edhe me drejtorin e shëndetësisë. Ky është një lajmë jo i mirë, njerëzit në nevojë nuk kanë nevojë të shkojnë në Malishevë ose në Gjakovë për të blerë barna, për këtë do e ftoj inspektoratin dhe së bashku me drejtorin e shëndetësisë, ku do provojmë që ti sanksionojmë sipas ligjit ata që nuk e respektojmë orarin e kujdestarisë. Sa i përket shqetësimit të z. Fehmi Cena, i nderuar shpresojmë se do të fillojmë nga e hëna procedurat për trajtimin e monumenteve historike, pastaj restaurimin e monumenteve, objekteve të rëndësishme së veçantë siç janë krojet, mullinjtë etj. pra në kuadër të specifikacionit është edhe ky krua sepse edhe neve na është thënë kur kemi qenë në atë lagje, por sigurisht edhe juve gjatë dëgjimeve publike. Sa i përket ndriçimit publik në Celinë apo Fortesë, kemi pasur disa defekte nga rrufeja, kemi pasur disa probleme me siguresa ku disa qytetar të papërgjegjshëm janë duke i hequr, por është fati i mirë që është lidhur kjo kontratë. E keni parë se në qytet ka filluar që të përmirësohet ndriçimi publik, kjo situatë do vazhdojë në të gjitha pozicionet ku kemi ndriçim publik, shpresojmë që ta lidhim kontratën e re për ndriçim të ri publik për ato vende ku nuk kemi fare ndriçim publik. Tani që kemi kontratë kemi të drektë që ta ftojmë operatorin që ta respektoj kontratën dhe aty ku janë pikat kritike të i rregullojnë. E nderuara znj. Florida Bajraktari e ka ngritur çështjen e shtratit të lumit të fshatit Brestoc, e nderuar ne i kemi në prioritet rregullimin e lumenjve, të cilët këtë vit janë treguar jashtëzakonisht problematik, ku na kanë sjellë probleme shumë të mëdha, si në Brestoc, Krushe të Madhe, Nagavc, Hoçë të Vogël dhe në shumë fshatra kemi pasur probleme. Ne po planifikojmë që ta

shtojmë seriozitetin, përkushtimin dhe ta fusim si prioritet dhe kur të vijmë në kuvend për aprovim të buxhetit do të shihni se ju kemi përkushtuar kësaj problematike. Të martën në ora 11:00 e kam një takim me Ministrin e Planifikimit ku shpresojmë se do të marrim lajme pozitive për sa i takon lumenjve nga Hoça e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc dhe Krushe të Madhe. Nëse ne do e marrim një përkrahje financiare nga kjo ministri, pastaj edhe përkrahja jonë si prioritet mendoj se do të ketë gjithsesi pastaj ndryshime pozitive në këtë aspekt. Ne do i dërgojmë edhe kërkesa të tjera si për lumin Rimnik, lumin Dullo, për lumin në Celin, për kanalet e kullimit etj. por besoj se do të jetë lajm i mirë që do futen si prioritete, ne vetë e kemi parë se sa keq e kemi gjendjen me lumenj. E nderuara znj. Besmire Bytyqi e pati një pyetje sa i përket pastrimit të hapësirave publike nga operatori, ky operator e ka fituar të drejtën që të operoj para dy ose tre viteve, e kam parë që dje e kanë kositur barin në qytetin e Rahovecit dhe në pjesën ku banoj unë dhe Besmira, menjëherë ka qenë reagimi imë ku kam biseduar me operatorin dhe i kam cekë se ai e ka për detyrë ta prej barin por edhe ti pastroj pastaj ato vende. Po ashtu i kamë parë punëtorët e ambientit duke i pastruar ato vende, mirë nga ana e tyre edhe pse nuk është detyra e tyre, ne do të kërkojmë zbatim të plotë të kontratës nga ana e operatorit. Sa i përket asaj që qytetorët duhet që të vinë në Komunë që ta nxjerrin tatimin në pronë sepse nuk mundën që ti nxjerrin nëpër zyrat e vendit, me sa kam biseduar unë me zyrtarin e teknologjisë informative, ku jemi mare vesh që të finalizohet sistemi online dhe të kenë qasja për pagesë edhe zyrat e vendit. Sa kam informata është punuar bukur mirë nga sektori i teknologjisë në këtë drejtim, se deri ku kanë mbërrit nuk e di sepse nuk jam ekspert i kësaj fushe. Por a ka filluar implementimi do të interesohem pasi të përfundoj ky takim. Sa i takon asaj që e the për infermierët do të përpiqem që kësaj radhe mos të lejojë që të bëjnë hajvar në objektin e QKMF-së, sepse kjo kishte ndodhë në vitet e kaluara. Do të kujdesem së bashku me drejtorin e shëndetësisë dhe drejtorin e QKMF-së, që ato motra të i kryejnë punët e veta e jo të mirën me punë që nuk duhet të mirën në QKMF. I nderuari z. Munib Durguti shqetësimi juaj është me vend, ne tani e kemi një rregullore e cila sot pret që të merë pëlqimin që të dele në debat publik ku do të parashihen edhe gjërat për këtë kategori. Deri më tani ata e kanë shfrytëzuar një situatë që deri tani edhe në mentalitetin tonë funksionon, hajt se tani është koha e dasmave dhe ahengjeve të ndryshme, ku e kanë vazhduar muzikën edhe deri në ora 02:00. Do të shohim dhe do të ja tërheqim vërejtjen brenda mundësisë ligjore, sepse ne deri më tani nuk kemi një rregullore që specifikisht e rregullon këtë problem. Kur të shkoj inspektorati dhe i tregon se për këtë shkelje do të gjobitesh me kaq para, besoni se ata pastaj do të hezitojnë që mos ta respektojnë këtë rregullore. Sa i përket problemit të AMF-së në Xërxë, me sa jam unë në dijeni operatori ja ka filluar punës për restaurimin e atij objekti, e vërtet është se drejtori i shëndetësisë së bashku me mua nuk ka lënë asnjë AMF ose QMF që nuk e kemi vizituar brenda këtyre 8 muajve. Është shumë mirë që është lidhë kjo kontratë, por unë do kërkoj pak më shumë edhe nga personeli mjekësor që është aty të kujdeset për këtë objekt sepse është i tyre, ata aty punojnë, kjo vlen edhe për shkollë, po ashtu edhe për këtë objekt ku jemi ne, vlen për çdo gjë që është aset publik. Pra të mos kërkohej vazhdimisht që dikush nga komuna të kujdeset si rojtarë, drejtori i shëndetësisë realizon politika shëndetësore, nuk shkon drejtori nëpër AMF të qëndrojnë si xhandar. Mirë që ka dalë ajo storie në televizion për këtë ambulancë, sepse çdo storie që del në publik neve na obligon ma shumë dhe ne do të bëhem më të përgjegjshëm dhe më të kujdesshëm, edhe pse nuk më pëlqej mënyra se si e dha intervistën kryetari i fshatit, por drejtori i shëndetësisë e ka mbajtur fjalën kurr ka thënë se nesër do të shkoj ta vizitoj, sepse ka shkuar menjëherë në mëngjes për ta vizituar. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi të martën e kam një takim me Ministrin e Bujqësisë dhe sekretarin permanent, edhe mua si kryetar komune më intereson se deri ku ka shkuar procesi i trajtimit të situatave që lidhet me vendimin e qeverisë së Kosovës për kompensimin e dëmeve. Deri më tani komuna e Rahovecit me faktet të cilat i ka dërguar në Ministrin e Bujqësisë janë diku rreth 4,800.000,00 €, duke ja shtuar edhe më shumë se 100,000.00 € nga të reshurat e ditëve të fundit në disa fshatra të Komunës sonë, këtë ne duam që të ja bashkëngjisim raportit të parë. Besoj se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës do të zbatohet, uroj që bujqit e komunës së Rahovecit të kompensohen 100%, po ashtu shpresoj se raporti jonë i dëmeve të jetë sa më i saktë. Sa i përket kalimit të trasesë së autostradës së Dukagjinit, besoj

se keni dëgjuar edhe ju që është nënshkruar kontrata për hartimin e projektit të autostradës së mbyllur Istog – Prizren me gjatësi prej 91 km, e kam kontaktuar menjëherë fituesin e kontratës, ku sipas ligjit fizibiliteti duhet që ti jepe dy opsione se nga duhet që të kalojë autostrada. Ata kanë marrë përsipër që pa u pyetur komuna e Rahovecit, komuna e Gjakovës, komuna e Prizrenit, të mos ndërmarrin asgjë, pra do të merren mendimet e qytetarëve të këtyre vendbanimeve. Kam planifikuar me operatorin i cili e ka fituar këtë kontratën me zhvillu një debat në këtë sallë të kuvendit, me njerëz që dinë se çka është kjo punë, ne do të luftojmë që të kemi qasje sa më të mirë në autostradën e mbyllur të Dukagjinit. A do të kaloj nëpër vendbanime apo skaj Drinit të Bardhë, ne nuk mundemi ta dimë sepse tek tani ka filluar projekti i fizibilitetit, në vitin 2019 do të filloj realizimi i ndërtimit të autostradës dhe atëherë do të dihet sakët se nga do të kalojë. Po ashtu dua të ju japë një lajm se Rruga Rahovec – Xërxë do të jetë katër kursi, nga viti 2019 do të filloj implementimi i kësaj rruge me katër kursi, kurse rruga e transitit do të mundohemi që ta bëjmë shiritin e tretë, ashtu siç jemi duke kërkuar në rrugën Rahovec – Suharekë, projekt i cili ka filluar që dy tre vite, ne jemi duke u munduar që të bëhet zgjerimi i kësaj rruge e jo vetëm shtrim me asfalt i rrugës ekzistuese, për arsye se aty është duke u ndërtuar zona ekonomike, po ashtu aty ne kemi pronë komunale dhe e kemi më të lehtë zgjerimin e rrugës. I nderuari z. Vahid Krasniqi sa i përket komisionit për emërtim të rrugëve, ne kemi kërkesa nga qytetarët e Komunës së Rahovecit për rrugë të paevidentuara, pastaj kemi disa paqartësi sepse disa shtëpi të kulturës p.sh në Krushe të Madhe quhet Muhamed Malësori, por nëse kjo nuk është me vendim të kuvendit atëherë duhet të bëhet me vendim të kuvendit, pastaj kemi rrugë të reja që janë pa emërtime, kemi shumë e shumë kërkesa të tjera nga qytetarë për emërtim të shesheve etj. Po ashtu kemi kërkesa për riemërtim të rrugëve të emëruara, por sidoqoftë dosjen e ka kryesuesi i kuvendit dhe ne pas miratimit të buxhetit të komunës nga ana e juaj në muajin shtator, do të provojmë që të i rregullojmë këto situata së bashku me kuvendin e komunës dhe komisionet. Nuk e di i nderuar a ka komision funksional tani apo jo, por nëse nuk ka ne do e formojmë një komision, ku pastaj këto shqetësime do të trajtohen me një kujdes të veçantë sepse kjo çështje aq sa është e rëndësishme është edhe e ndjeshme. Besoj se jam përpjekur me i dhënë përgjigje temave të cilat ju i keni ngritur sot në këtë seancë.

Dervish Çadraku – E përcolla fjalimin e kryetarit me shumë vëmendje dhe e kam hetuar diçka tek kryetari, jo vetëm në këtë mbledhje të kuvendit, por edhe në mbledhjet e tjera përgjigjet gjithmonë i ka po, mirë është, do të ishte mirë, do të shohim, dhe ne kuvendarët në një farë mënyrë duhet të ju rikujtojmë, ose të ju prishim gjumin e qetësisë. Nuk ka pasur nevojë të vije televizioni nga Prishtina që të shoh në atë gjendje ambulancën në Xërxë, kryetari e tha se i ka vizituar së bashku me drejtorin e shëndetësisë së paku 3 herë këto ambulanca, atëherë është dashur të intervenohet. Pastaj nuk është dashur që të përsërisë pyetjen për problemin e ujit, nuk është dashur të përsëritet pyetje sa i përket muzikës gjatë orëve të natës, nuk është dashur që të ju rikujtojmë se barnatoret nuk janë duke ju përmbajtur orarit të punës etj. Prandaj i nderuar kryetar është mirë që herrave të tjera të jeni pak më të qartë, dhe shumë më shumë të informuar se ne.

Kryetari – E kam një këshill për z. Dervish Çadrakun, përgjigje më konkrete për shqetësimet që ju i keni ngritur nuk e di se si duhet të jenë. Sa i përket çështjes së ujit po ju bëjë vetëm një ilustrim, ky është një problem që 10 vite, nuk e di se si të ju tregoj ndryshe është mirë që ti hapni veshët pak më mirë, çështja e ujit të pijes nuk ka qenë e planifikuar për këtë vit, por është aftësi e imja dhe e ekipit tim, ku pas presionit që e kemi bërë është planifikuar për këtë vit, dhe problemi i ujit të pijes do të zgjidhet. Pastaj autostrada, të nderuar ende nuk ka filluar projekti i fizibilitetit, të nderuar mos e lidhni projektin e fizibilitetit me fillimin e punimeve në autostradë, me të vërtetë më vije keq kur ju shohë se sa mbrapa jeni me informata. Për ma shumë informata do të flasë vetëm atëherë kur do i mare informatat e sakta nga ministria ose punëkryesi, pastaj do vije vetë punëkryesi në kuvend, ku ai do ju tregoj se ku dhe ku janë alternativat e autostradës së Dukagjinit. Pastaj ne do i tregojmë qëndrimet e komunës së Rahovecit për autostradë, ne tani për tani jemi në fazën e hershem që të kemi informata të sakta. Sa i përket mosrespektimit të orarit për barnatore, po ju them edhe një herë është rregullorja, por ka 8 vite që nuk është duke u zbatuar, por duhet që ta dini se kjo çështje nuk lidhet vetëm me administratën komunale, edhe inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë ta bëjë

një vizitë këtyre barnatoreve dhe të shikojë se a janë duke e respektuar orarin e punës. Por unë si kryetar i komunës ju premtova që do të kujdesem për këtë çështje, unë këtë shqetësim e kam ngritur para juve, që në ditët e parë kur kam ardhur në pushtet. sepse kemi shqetësime nga qytetarët. Përgjigje konkrete ju dhashë edhe tek çështja e ambulancës në Xërxë, por kuptoni diçka, besoni se ka media në Kosovës nëse dikush e thyen një shishe menjëherë të gjitha mediat i ke në Rahovec, por nëse unë i ftojë së bashku me ju ndonjë media besoni se nuk do të vijnë. Ne nuk kemi gjetur fare projekt, pra ne i kemi angazhuar inxhinierët e komunës, po ashtu edhe kompaninë e cila harton projekte për komunën, por ajo zgjatë nuk mundet të bëhet aty për aty, sepse kompania duhet ta hartoj projektin, pastaj duhet që të hyhet në procedurat e prokurimit, të cilat ndonjëherë marrin kohë deri në dy muaj. Por siç ju thash lajmi i mirë është që ka filluar renovimi i shtëpisë së shëndetit në fshatin Xërxë, tjetër përgjigje nuk kam. I nderuari Dervish ne jemi duke u marrë me këto punë për çdo ditë. Prandaj mendoj se përgjigje të qarta i keni marr për të gjitha pyetjet që i keni parashtruar, dhe po ju siguroj juve dhe qytetarët e komunës së Rahovecit që nuk jam në gjumë, por jam shumë i interesuar së bashku me ju që këtë komunë ta qojmë sa ma përpara, ndryshe nuk e di se si të ju japë përgjigje.

Kryesuesi – E falënderoj kryetarin për përgjigjet e bërë në pyetjet e kuvendarëve, nuk keni të drejtë të bëni dy herë pyetje, e keni pasur mundësin për të bërë dy pyetje. Të drejtë në pyetje kanë vetëm ata të cilët nuk kanë bërë pyetje.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një shqetësim sa i përket ambulancës në fshatin Çifllak, në këtë ambulant është punësuar një teknik i ri të cilin nuk e njoh dhe nuk kam asgjë personale me te, por gjatë vikendit i kam bërë dy muskulare ku njëra ka qenë shumë poshtë dhënë, pacientit ju kishte bërë komplet këmba kaltër, kjo është tek familja e Pjeter Gojanit, po ashtu edhe një rast ka ndodhur edhe te familja e Hazer Bajres, ku muskulorja ju është dhënë tek ashti, besoni se këtë gabim nuk e bënë asnjë amator nga shkolla e mesme, nuk e di si nuk është duke i paralizuar njerëzit. Sopa e kryen shumë mirë punën profesionale, por i mungon komunikimi, pastaj Masari është aty dhe jep vaksina, unë kur i kryej në repartin tim punën, aty ku ka nevojë shkoj për të ju ndihmuar sepse edhe në kontratë ashtu shkruan, prandaj edhe z. Masari mundet që ti ndihmojë Sopes. Kurse atë teknik që e keni punësuar kishte me qenë mirë që ta dërgoni diku në trajnim që të mësoj punën para se të paralizoj dike. E kam edhe një shqetësim sa i përket varrimit të veteraneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sipas disa informatave Malisheva asnjë varim të veteranëve nuk e bënë pa togë ceremoniale, pyetje ime është pse komuna e Rahovecit nuk e ftojnë togën ceremoniale kur bëhet varrimi i ndonjë veterani. Ne si fshat këto ditë i kemi pasur dy fatkeqësi, një fatkeqësi i ka ndodhur drejtorit Afrim Limanit, të cilit i uroj shërim të shpejtë, dhe sa më shpejtë të kthehet në mesin tonë, fatkeqësia tjetër është e Nazimit, një njeri që e ka mbajtur babanë e vetë në luftë, pastaj e dini të gjithë gjendjen e tij, por pavarësisht asaj ai ka qenë ish ushtar i UÇK-së. E falënderojmë kryetarin e shoqatës të dala nga lufta i cili ka mbajtur edhe fjalim gjatë varrimit, por pyetje ime është pse nuk është përcjellë me togë ceremoniale. Shqetësimi tjetër i imë është se ne jemi bërë njëjtë sikurse në Bajram Curr, a ka mundësi që policia e Kosovës të bëjë më shumë patrullime në fshatra, e mos të kenë më nevojë të i ruajnë shtëpitë e tyre vetë banorët e fshatrave.

Astrit Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje nuk kam sepse kryetari i komunës ju përgjigje asaj pyetje të cilën kam pasur unë të ja parashtroj rreth kompensimit të dëmeve në bujqësi. Por ju i nderuari kryesues pak më parë u ngutët dhe ja dhatë fjalën kryetarit të komunës para se ne të i kryejmë pyetjet drejtuar ekzekutivit.

Kryesuesi – Nëse dikush e ka ngritë dorën dhe unë nuk ja kam dhënë fjalën, i kërkoj falje, por nuk është bërë me qëllim, sepse çdo kuvendar ka të drejtë të i parashtroj dy pyetje ekzekutivit, por ne ju toleruam dhe jemi duke lejuar edhe nga tre pyetje të i bëni.

Fehmi Cena – E kam për obligim me ndërhy me një reagim të shkurtër sepse u përmend QKMF-ja, dhe unë aty jam duke punuar, po ashtu këtu në sallë jemi 3 persona të cilët kemi qenë drejtorë të drejtorisë së shëndetësisë, këtu është edhe drejtori aktual. U përmend këtu çështja e ajvarit, unë as që kam parë dhe as që

kam dëgjuar se në QKMF është bërë ajvar ndonjëherë, prandaj unë këtë e kundërshtoj, nëse keni fakte tregoni, sepse ajo që flitet këtu është fjalë publike dhe e dëgjon opinioni dhe mediat, kjo është dezinformata.

Kryetari – E nderuara znj. Afërdita Thaqi sa i përket vjedhjeve ne kemi diskutuar me policin e Kosovës në KKSB, po ashtu tani i kam dërguar 3 drejtorë në një tubim me policin mu për këto çështje. Gjithashtu jam në kontakt të rregullt me policin e Kosovës stacioni në Rahovec, edhe ne jemi të shqetësuar i kemi kërkuar një mobilizim pak më të madh policisë, krejt ka duhet të bëhet nga ana e jonë është duke u bërë. Sa i përket varrimit të veteranëve ajo është përgjegjësi e OVL-së, më vije keq por Malisheva i ka rreth 3-4 gjeneral, kurse ne asnjë nuk kemi, jo që ne nuk kemi luftuar dhe që nuk kemi kontribute, por duhet që të kuptoni se jo çdo veteran varroset me togë të nderit, është një procedurë mjaftë komplekse deri sa të vish tek toga e nderit. Sa i takon çështjes së mungesës së aftësive të atyre që shërbejnë në qendrat e mjekësisë familjare, pajtohem me ju që mundet të ketë edhe mungesë, por nëse ne do të kemi ndonjë ankesë serioze në atë që e tha znj. Afërdita, normalisht që drejtori i shëndetësisë do të përkujdeset, por edhe prokuroria, hetuesia dhe të gjitha organet përgjegjëse do të kujdesen sepse për këto punë janë aty. Por sidoqoftë unë i lusë ata që janë pak më me përvojë që ti mësojnë ata që janë më me pak përvojë sepse askush nuk ka lindur i ditur dhe as me përvojë, por fitojnë përvojë nga ata që dinë pak më shumë.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve edhe një herë për pyetje e bërë, po ashtu falënderojmë kryetarin për përgjigjet e dhëna. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i informatës së qarkores buxhetor për vitin 2019.

Kryetari – Në mungesë të drejtorit për buxhet dhe financa z. Afrim Liman i cili ka pësuar një aksident së bashku me drejtorin për ekonomi dhe zhvillim z. Artan Asllani, dhe për momentin gjendet në spitalin e ortopedisë në QKUK. Kjo është një informatë përkitazi me qarkoren e dytë buxhetore, është një dokument dhe besoj se këta që janë më me përvojë e dinë se buron nga Ministria e Financave, po ashtu qarkorja e dytë në një farë mënyre e ka për qëllim që të qartësoj dhe precizoj limitet buxhetore. Me anë të kësaj ne mundemi të shohim se cili do të jetë buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2019, sa do të kemi mallra dhe shërbime, subvencione, transfere, investime kapitale dhe sa shërbime komunale. Në këtë qarkoren e dytë buxhetore ka disa zhvillime pozitive, e para ne jemi përpjekur që të zhvillojmë një situatë më të harmonishme midis asaj se sa planifikojmë që të realizojmë të hyra vetanake, në mënyrë që ky planifikim të jetë më i mirë, ne e kemi ulur planifikimin i cili ka qenë mbi 1.6 milion, tani është 1,168,000.00 €, sepse komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka mundur që të ketë kaq të hyra. Kemi rritje të subvencioneve për 60,000.00 €, pra nga 191,000.00 € tani i kemi 250,000.00 €, kemi rritje në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa kemi ulje në kategorinë e investimeve kapitale. Pastaj kemi rritje të punëtorëve në shëndetësi, ku do të punësojmë 8+1 punëtor të ri, pra një kërkesë e kahershme të cilën komuna e Rahovecit ka 20 vite që është duke e bërë, por për fat të mirë tani kjo kërkesë është realizuar. Ne si komunë kemi shumë më pak mjek se sa që kemi banorë, nëse shkojmë përmes formulës që duhet aplikuar për shëndetësi. Lajmi i mirë po ashtu është se kemi rritje progresive të buxhetit, grand i përgjithshëm është rritur për 230,000.00 €, buxheti i këshillit të Hoçës së Madhe ka 1,000.00 € më shumë këtë vit, shëndetësia diku mbi 100,000.00 € më shumë buxhet këtë vit, drejtoria e arsimit për 80,000.00 € më shumë, grand i qeveritar dhe të hyrat vetanake gjithsej bëjnë 3, 490,000.00 €. Të nderuar buxheti i përgjithshëm është 13,658,892.00 €, ndoshta di ju duket që ka zbritje të buxhetit, por kjo ndodhë për arsye se ka zbritje të të hyrave vetanake, kjo është pra arsyeja. Besoj se nuk kam gabuar diçka rreth shpjegimit të buxhetit, sepse nuk jam ekspert i këtij drejtimi, por i kam njerëzit të cilët i kamë autorizuar që të mirën me këtë, si Ardian Rama, Arben Sokli dhe Ramadan Kadiri. Për fund edhe një herë ju them, besoj se ju e dini që ne nuk mundemi që të ndryshojmë qarkoren buxhetore.

Florije Boshnjaku - Falënderoj kryetarin e komunës për këtë informatë, uroj që drejtori i financave të kthehet sa më shpejtë ne vendin e punës. E përgëzoj qeverinë komunale për kërkesën e dërguar për shtimin e numrit të punëtorëve në shëndetësi, sipas informatave që na ka dhënë drejtori i financave në KPF, edhe një punëtor në arsim do të punësohet, pra gjithsej 9 punëtor do të punësohen, dhe më vije shumë mirë kjo punë

që është duke ndodhur. Sa i përket të hyrave vetanake, puna e juaj dhe e qeverisë qendrore në këtë aspekt ka qenë shumë me vend, këtë e kam kërkuar edhe nga qeverisja e kaluar sepse nuk mundemi që të planifikojmë diçka që nuk mundemi ta realizojmë. Në lidhje me çështjen e buxhetit gjinorë e shohë që e kemi në këtë qarkore buxhetore, e kam shumë të qartë se kjo vije nga qeveria e Republikës së Kosovës dhe kjo mundet të ndryshohet vetëm nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por neve si anëtar të kuvendit komunal kjo informatë shumë na është dashur, për këtë kam diskutuar edhe me drejtorin për financa, ku shpresoj se do të mirën parasysh edhe propozimet të cilët kanë dalur nga dëgjimet buxhetore. Po ashtu duhet që të bisedohet edhe me Ministrin e Arsimit që të parashihet ndërtimi i çerdheve në fshatin Ratkoc dhe Krushe të Madhe sepse kjo është një kërkesë e grave.

Rasim Fazliu – Në KPF ne kemi diskutuar dhe drejtori limani na ka informuar qartë, shpresojmë se drejtori do të shërohet sa më shpejtë dhe të kthehet në mesin tonë. Mirë është bërë që është ulur planifikimi i të hyrave vetanake, por Ministria e Financave është dashur këtë të bëjë edhe më herët, sepse ka pasur kërkesa të vazhdueshme edhe nga qeveritë e kaluara, ata e kanë ditur historikisht se asnjë herë në komunën e Rahovecit nuk janë mbledhur 1,600,000.00 €, por ata i kanë pasur limitet e veta dhe nuk kanë pyetur askënd, prandaj është bërë shumë mirë që këtë vit kanë rënë në limitet që duhet. Edhe disa lëvizje që janë bërë në mallra dhe shërbime, në investime kapitale, është mirë që kanë ndodhur për arsye se vazhdimisht kemi pasur vërejtje nga auditori i përgjithshëm. Besoj se më tepër nuk kemi se çka të bisedojmë sepse kjo është një informatë, falënderojmë edhe një herë drejtorin e financave.

Mirjeta Krasniqi – Falënderoj drejtorin për këtë informatë, po ashtu i uroj shërim sa më të shpejtë, sa i përket kësaj pike kam një vërejtje sa i përket formatit të numrave dhe shkronjave që janë përdorur në këtë tabelar, është përdorur një format shumë i vogël dhe është pak problem të lexohet, e di se kjo është bërë në nivel qendrorë, por ndoshta keni mundur të gjeni një mënyrë që kjo tabelë të jetë në dy faqe dhe të jetë e lexueshme. Sa i përket ngritjes së punëtorëve në drejtorin e shëndetësisë ky është një lajm shumë i mirë, por pyetja ime është: A është mundur të gjendet një mënyrë për të i punësuar së paku dy psikolog ose pedagog në drejtorin e DKA-së, sepse edhe kjo është shumë e nevojshme për shkollat e komunës sonë.

Kryetari – Në qarkoren e dytë buxhetore është e specifikuar që edhe pagat jubilarë për mësimdhënësit që dalin në pension, komuna jonë saktë e ka artikuluar kërkesën dhe kjo temë më nuk është temë e gjykatave, pra kjo temë për pagesë të tre pensione për mësimdhënësit që dalin në pension është zgjidhur për tërë Kosovën. Komuna jonë nuk dëmtohet asgjë sepse kërkesat i ka dërguar me kohë. E nderuar edhe pse është lajmë i mirë ngritja e numrit të punëtorëve në shëndetësi, por unë nuk jam ende i kënaqur sepse ka nevojë ende. Kurse sa i përket psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, do të kërkojë deri sa të bëhet një zgjidhje, ne si ekzekutiv në emër të DKA-së ju kemi adresuar Ministrisë së Financave që në qarkoren e dytë të përfshihen edhe psikolog dhe pedagog, por pasi që nuk është bërë unë do mundohem që një grup të pedagogëve dhe psikologëve të i punësoj nga viti i ardhshëm me anë të Caritas Kosova. Me ministrin e financave i kam marrëdhëniet shumë të mira edhe personale, kam një farë zotimi se disa nga kërkesat që i kemi ne eksplicit të i vije radhë që edhe komunës sonë të i kryhen, sepse disa komuna i kishin kryer.

Fehmi Cena – Ne këtë qarkore buxhetore e patëm shqyrtuar edhe në KPF, ku në këtë mbledhje e patë prezantuar drejtoi i financave z. Afrim Limani, të cilin e përshëndes dhe i uroj shërim sa më të shpejtë. Nga kjo qarkore jemi të informuar që kemi rritje buxhetore në të gjitha pozicionet, përpos në pozicionin e shërbimeve dhe mallrave që është duke u parë që ka një rrënjë, por për vete e përshëndes këtë veprim sepse këto janë pozicionet të cilat duhet të kursehet paraja, por ajo që më gëzon është rritja e pozicionit të subvencioneve, por unë do kërkoja që komuna jonë në të ardhmen të kërkojë që në këtë pozicion të ketë rritje edhe më shumë, duke marrë parasysh që komuna jonë është komunë bujqësore. Në shëndetësi u tha se ka rritje të numrit të punëtorëve, u përmend më duket se 8 veta, edhe kjo na gëzon sepse me të vërtet ka nevojë sidomos për mjek. Sugjerimi imë është kur të vije ky vendim mos të ngutemi menjëherë që të i zëmë vendet e punës, sepse komuna jonë karakterizohet me mungesë të mjekëve në mënyrë kronike, prandaj duhet që të kemi primare pranimin e mjekëve. Ndërsa sa i përket infermiereve nuk besoj se ka pak kemi

mjaftë dhe ata më lehtë munden të punësohen përmes këtyre kontratave të përkohshme, siç është bërë deri më tani me Caritasin. Diçka tjetër që desha të përmendi është edhe çështja të cilën edhe kryetari e përmendi, pagesa e tre pagave pas pensionimit, në KPF u tha se vetëm punëtorëve të arsimit i takojnë këtë tre paga pas pensionimit, pyetje ime është: Çka do të bëhet me kategoritë e tjera p. Sh me punëtorët shëndetësorë kur të dalin në pension, në KPF e kemi marrë një përgjigje negative dhe nëse me të vërtetë është ashtu atëherë nuk është në rregull, pse mësimdhënësit të veçohen, pse ata të kenë të drejtë ne jo, sipas cilëve kritere kjo është bërë, duke e ditur se shëndetësia dhe arsimit janë të njëjtës kategori, janë shërbyes publik, unë jam që edhe kategoritë e tjera të kenë të drejtë, pra të jenë të gjithë të barabartë. Kisha pas dëshirë të kem një përgjigje të saktë sepse punëtorët dhe unë vetë jam duke pyetur se si është gjendja.

Dervish Çadraku – E rëndësishme është se ka zhvillime pozitive sa i takon këtij dokumenti që na ka ardhur, interesi i qeverisë është ruajtja dhe stabiliteti makro fiskal, po ashtu ne nuk mundemi me i pas të gjitha ato që kërkohen sepse kjo është një kategori e cila është për gjithë Kosovën. Ajo që mua më intereson është: Ne kemi diku 3 ambulanca që nuk kanë punëtor ose mjek, ato ambulanca për momentin janë të mbyllura, cili është limiti i shërbyesve civil që i lejohet të i ketë komuna jonë, a do të kemi ne mundësi tani që ti mbulojmë këto vende të punës, sepse e dini të gjithë që në të kaluarën është kërkuar nga komunat që ta ulin numrin e shërbyesve civil, ndërsa me ardhjen në pushtet ju i keni punësuar më shumë se 15 veta, kurse tani po kemi probleme që ti plotësojmë ato vende në ambulancë për të cilat kemi nevojë.

Kryetari – Besoj se kjo që u tha deri më tani ka të bëjë me këtë qarkoren e dytë buxhetore që jemi duke e diskutuar sot, si duke z. Dervish Çadraku qenka i disponuar që të bëjë polemika me mua. E para shërbyesit civil janë shërbyesit civil, çuditërisht me z. Dervish Çadraku, ka punuar në Komunë ka qenë drejtor, grandit të shëndetësisë ne kemi të drejtë me i dhanë por kursesi me i marrë, pra ne nuk guxojmë asgjë me prek në shëndetësi, shtimi numrit të mjekëve dhe infermierëve nuk ka lidhje me punësim e shërbyesve civil. Ne jemi në krizë me mjekë nuk kemi, formula nuk është duke u zbatuar, por shpresojmë se nga viti 2019 të zbatohet. Këta 8 mjekë për formulën që duhet të zbatohet për komunat e Republikës së Kosovës nuk është numër i mjaftueshëm për komunën tonë, ne jemi të detyruar në vitin 2019 të kërkojmë mjekë nga komunat fqinje, kurse infermierë kemi mjaftë. Ambulancat është e vërtetë që disa nuk janë funksionale, si ajo në Malësi të vogël, Brestoc, Polluzh, por arsyeja është se nuk kemi mjek. Prandaj shtimi i mjekëve nuk ka të bëjë me punëtorët e shërbimit civil. Pastaj sa i takon punësimit e rëndësishme është që Smajl Latifi askënd nuk e ka qitë prej pun, në çdo komunë të Kosovës punësohet dikush, nuk ka rëndësi kush i punëson, me rëndësi është që të jenë në funksion të zbatimit të ligjit. Çdo vendim që vije nga organet tjera që e monitorojnë procesin e rekrutimit komuna e Rahovecit i përmbahet, ku të marrim ne të punësojmë njerëz, por uroj që më së paku të punësohen në administratë, sepse Kosova duhet që të reduktojë personelin në administratë publike është standard i BE-së, por duhet që të shikojë mundësitë që ti punësojë në sektorin privat, por ja që fronti më i madhi i punës ka mbetur arsimit, shëndetësia dhe administrata, po ashtu dëshira e njerëzve për të punësuar në sektorin publik është më e madhe sepse e ndien vetën më të sigurt. Por duhet që të dini se ne nuk mundemi me e shpallë një konkurs në mënyrë automatike, sepse ne duhet që të marrim leje nga ministrinë përkatëse, pra duhet që të kalohet nëpër disa procedura deri sa të aprovohet pëlqimi për hapje të një vendi pune. E pse nuk është punësuar Smajli por Dërvishi, Smajli e ka të drejtën e vetë po ashtu edhe Dërvishi të veten, nëse ju ka bërë e padrejtë atëherë le të ankohet tek organet përkatëse.

Munib Durguti – Fillimisht i uroj shërim sa më të shpejtë drejtorit të financave, e kuptojmë që nuk mundemi të ndryshojmë diçka rreth kësaj informate dhe nuk kemi se çka të diskutojmë, por mendoj se është diçka e mirë nëse e shikojmë në tërësi. Në radhë të parë është harmonizuar planifikimi me realizimin, kjo gjithmonë na ka sjellë probleme, sepse gjithmonë kishim probleme pse një drejtori nuk ka mundur që ti realizojë mjetet në bazë të planifikimit, ne të gjithë e kemi ditur se planifikimet nuk kanë qenë reale. Po ashtu ju përgëzojë për angazhimin që jeni duke bërë në rritjen e numrit të punëtorëve në sektorin e shëndetësisë, dua që të ju kujtoj se në vitin 2016-2017 kemi parashtruar një kërkesë në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Shëndetësisë, pas një elaborati që e kemi bërë në teren për numrin e punëtorëve,

ku kemi parë se ne si komunë qëndrojmë jashtëzakonisht keq karshi disa komunave. Udhëzimi administrativ për nivelin primar shëndetësorë thotë: Në mjek i përgjigjet 2000 banorëve, komuna jonë i ka rreth 60.000 dhe duhet që ti ketë 30 mjekë familjar, ndërsa ne në dispozicion i kemi vetëm 13 duke i llogaritur edhe ata mjek që janë në specializim për mjekësi familjare. Në këtë kategori nuk përfshihen mjekët si urologu, internisti etj. Ka pak mungesë edhe në infermieri, edhe pse bashkëpunimi me Caritasin çdo vit është duke u bërë, por prapë mungesa për infermierë është e nevojshme, po ashtu edhe unë ju kisha bashkëngjitur kërkesës që të kemi një menaxhim sa më të mirë të prioriteteve. Po ashtu është bërë një plan tash e dy vite për trajnimin e personelit në qendra emergjente, të gjithë mjekët kanë pranuar që kanë nevojë që ato njohuri ti rifreskojnë, kemi shumë raste që na vdesin pacientë prej mosdijes së stafit, kjo në këtë rast nuk mundet të konsiderohet si vepër penale, por kemi të bëjmë me një nivel që i mungon personelit, obligimi i institucionit është që të aftësojë personelin. Në kohën deri sa kam qen drejtor i shëndetësisë kam kontaktuar me drejtorin e qendrës emergjente në QKUK, dhe me drejtorin spitalit në Gjakovë, ata janë shprehur të gatshëm dhe ka mbetur që vetëm ne ta caktojmë një ditë dhe të shkojmë me një staf të cilin ata do i trajnojnë për 3-6 muaj. Ka shumë aparatura që i kemi sjellë në QKMF por personeli nuk është i gatshëm me i përdorë.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit paraparak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Afrim Oruçi – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, propozimi ka të bëjë me zonën kadastrale në fshatin Radostë, propozimi i kryetarit të komunës është që të bëhet ndërrim destinimi i tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore parcela me nr. P-71510067-01271-9, këtu kemi të bëjmë me pronë private tokë e klasit të tretë me sipërfaqe prej 4 ari, me pronar Latif Zena. Pronari aktual këtë parcelë e ka trashëguar para disa javëve nga vëllezërit e tij. Të nderuar kemi të bëjmë me një kërkesë të një pronari i cili është riatdhesuar në Kosovë, po ashtu kjo kërkesë ka të bëjë me fillimin e procedurave për ndërtimin e shtëpisë, pasi që ka fituar një grand nga ministria. Por ky institucion ka kërkuar që ky të i nënshtrohet kushteve për leje ndërtimore dhe njëri nga kushtet është që kjo pronë private e cila tek ne figuron si tokë bujqësore të destinohet dhe të kthehet si tokë ndërtimore dhe tek pastaj të realizohet grandi dhe të fillohet me ndërtim të shtëpisë. Ju ftoj që pas shqyrtimit nga ana e juaj ta mbështetni këtë propozim vendim.

Sali Sallteku – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, e njohë mirë këtë rast sepse jam bashkëfshatar i tij, në afërsi të kësaj parcela ka shtëpi dhe besoj po ashtu as ata nuk i kanë të evidentuar si vendbanime ato toka ku i kanë ndërtuar shtëpitë, prandaj mos të humbim kohë si deri më tani që humbëm, le të kryhet formalisht kjo procedurë, po ashtu pasi e dimë se si e ka pasur fatin ky bashkëfshatar, prandaj është mirë që ta përkrahim në mënyrë që ta përfitojë këtë donacion, ky njeri ka pasur problem familjar shumë të madhë, prandaj le ta kryejmë këtë punë dhe le ti ndërtohet një shtëpi këtij njeriu në mënyrë që të ketë një kulem mbi kokë.

Rasim Fazliu – Mendoj pak më ndryshe se kolegu imë, ne kemi ardhur këtu që të debatojmë dhe diskutojmë, që mos të diskutojmë nuk është dashur fare të vijmë në mbledhje. Ne në KPF e kemi diskutuar gjerësisht këtë propozim vendim, ku i kemi ngritur shqetësimet tona, ne jemi të vetëdijshëm se në komunën e Rahovecit por edhe në komunat e tjera qytetarët fare nuk pyesin kur ndërtojnë objekte, po ashtu edhe ky do ta bënte të njëjtën gjë, por pasi është investim nga ministria është detyruar që të merë një pëlqim nga ky kuvend. Por duhet që ta keni të qartë si ju kuvendarët ashtu edhe ekzekutivi kategoria nga 1-4 nuk kemi të drejtë ne si kuvend komunal të marrim vendime pa pasur një parapëlqim nga ministria përkatëse, prandaj në KPF e kam kërkuar që së pari të na vije një pëlqim nga ministria. Po pasi ky zotëri e ka si e ka punën ja kishim bërë të mundur me ja dhënë një pëlqim, por shpresoj që nuk do të kemi pastaj implikime ligjore dhe të na kthehet nga ministria sepse kemi bërë shkelje të ligjit. Për shkak që është një rast i veçantë pajtohem me z. Sali Sallteku që mos ta zgjasim më tepër. Ne emër të grupit të PDK-së pajtohem që kjo parcelë të shndërrohet nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Sali Sallteku – Nuk është replikë por vetëm desha të them se kjo parcelë është në mes shtëpive të vëllezërve të tij, është vendbanim, kjo ishte arsyeja pse e thash që mos ta zgjasim, ndërsa sa i përket asaj e di që nuk duhet të bëjmë shkelje, por këtë rast e njohë shumë mirë dhe e di që kjo pjesë vetëm është vendbanim.

Rasim Fazliu – Desha të diskutoj pak sa i përket dokumentacionit që e ka hartuar drejtori, kishte me qenë mirë të ceket tek pika tre e vendimit, se a është kompensim i tokës përkohshëm apo i përhershëm.

Masar Popaj – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, ky propozim vendim që na ka ardhur nga kryetari i komunës për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, duke u bazuar preambulën e ligjit Nr.2/L- 26, neni 10, paragrafi 2, dhe udhëzimit administrativ nr.41/2006, neni 6, paragrafi 6.2, dhe neni 8, paragrafi 8.4 thotë: Ndërrimi i përhershëm i të tokës bujqësore të klasës 1-4, do të bëhet me vendimin e kuvendit komunal pas marrjes së pëlqimit nga ministria. Ne këtu kemi të bëjmë me tokë bujqësore të klasit të tretë, për vete jam që ta përkrahim këtë person, por frikohem mos bëjmë shkelje ligjore.

Florije Boshnjaku – Këtë vendim e kemi shqyrtuar edhe në KPF, plotësisht pajtohemi me parafolësit për atë që e thanë sa i përket ligjit, por për raste specifike shumica jemi që ta përkrahim këtë familje. Në KPF i kam dhënë disa propozime tek pjesa hyrëse aty ku ceket emri dhe mbiemri duhet të ceket edhe vendbanimi pra nga fshati Radostë, pastaj jo vendimi paraprak, por duhet të jetë vendim për ndërtimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Tek neni 2 duhet të ceket se destinohet për ndërtimin e shtëpisë, kjo është e rëndësishme të ceket, pastaj tek neni 3 sa e di personat që janë të riatdhesuar lirohen nga taksat, prandaj këtu duhet të bëhet një ndryshim, pra të dihet se a duhet të paguaj ky person apo jo.

Fehmi Cena – Nuk dua të shqyrtoj këtë pikë si rast individual me emër dhe mbiemër, po do e shqyrtoj si dukuri, e kam potencuar edhe në KPF, po e potencoj edhe tani, komuna jonë duhet të ketë kujdes që mos të lejojë ndërtime në toka bujqësore, pra të ruhet toka bujqësore. Jemi të vetëdijshëm që po kemi ndërtime të egra gjithandej, ne karakterizohemi si komunë bujqësore prandaj edhe duhet që të mbrojmë maksimalisht, nuk jam kundër këtij rasti sepse është rast i veçantë, sepse i takon kategorisë së riatdhesuarve. Kur jemi tek kjo kategori, ky nuk do të jetë rast i vetëm komuna jonë do të ballafaqohet edhe me raste të tjera, por desha të them se ekzistojnë ndërtesat për banim kolektiv, banesat sociale, ku mendoj se duhet të jenë në kuadër të strategjisë dhe politikave sociale të komunave. Kishte me qenë mirë që të mendohet në të ardhmen që këta persona që vinë nga jashtë, dhe nuk kanë shtëpi banimi, është mirë që ata përkohësisht me gjete strehë pikërisht në këto ndërtime kolektive.

Dervish Çadraku – Është e vërtetë që ky njeri i cili është bashkëfshatar i ynë ka shumë nevojë për një ndihmë, sepse ky është një rast i veçantë dhe shumë i rëndë, ky njeri ka një të kaluar traumatike. Po ashtu e dimë se me këtë jemi jashtë rregullave ligjore, dhe kjo nuk është aspak mirë, por po ashtu duhet të dimë se është obligim i yni që të rregullohet problemi i planit urbanistik, në këtë mënyrë të dihet se ku ke drejtë të ndërtosh ndonjë objekt, ne këtë punë nuk e kemi kryer. Ne tani jemi duke bërë ma shumë zhurmë për këtë rast i cili ka shumë nevojë se sa për ndërtimin e hotelit bërnjakëve, këto janë dy raste ekstrem të kundërta, i pari është rast shumë i rëndë i cili ka nevojë për ndihmë, kurse rasti tjetër është krejt diçka tjetër. Prandaj nuk është mirë që të bëjmë zhurmë, ne jemi duke e thye ligjin për çdo ditë, ndërsa ky ka ardhur me këtë kërkesë sepse patjetër i duhet në mënyrë që ti tërheq ato mjete nga ministria, se përndryshe as këta nuk na kishin pyetur si gjithë të tjerët që nuk po pyesin. Kërkoj nga kolegët e mi që ta përkrahin këtë rast sepse është rast shumë i rëndë.

Kryetari – Pa dashur të hy në çështje konkrete, por dua të ju bëjë me dije se kuvendi i komunës së Rahovecit nuk e shkelë ligjin, nuk e ka shkelë kur deri më tani, edhe nëse ka bërë shmangieje janë organet e tjera që e japin përgjigjen përfundimtare. Ne duhet ta kryejmë punën tonë, ne ju kemi sjellë një propozim për një rast konkret, duhet të dini se ne nuk e kemi shkelë ligjin as atëherë kur ja kemi dhënë Stone Castle, as nuk do të shkelim tani sepse është MAPL-ja ajo e cila jep përgjigjen e fundit nëse shkelet ndonjë nen. Nuk është mirë të thuhet se jemi mësuar që ta shkelim ligjin, nuk e shkelë ligjin as z. Dervish Çadraku, as unë dhe as ju. Jam pro këtij vendimi dhe më mirë të ketë një vendim legal, edhe pse është tokë bujqësore sepse të gjitha ata të tjerë janë ilegal, ata nuk e kanë pyetur askënd dhe kanë ndërtuar.

Isak Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ja nisi nga pëlqimi i ridestinimit, kemi një udhëzim administrativ i cili e përcakton qartë ridestinimin e pronës është 41/2006, i cili ka dalë me datë: 27.12.2016. ligji për vetëqeverisje lokale është dalë në vitin 2008, pastaj këtu është i implikuar edhe ligji për planifikim hapësinorë dhe në bazën e nenit 17.1 të këtij ligji ne kemi të drejtë me e bërë ridestinimin, por edhe ky është nderuar dhe nuk është më, tani e kemi ligjin e ri i cili ka dalë në vitin 2013. Pastaj kemi ligjin për tokat bujqësore që është i kyçur në këtë vendim, udhëzimi administrativ të cilin ju jeni duke e përmendur është dal para të gjithë këtyre ligjeve dhe akteve që i përmenda, është nga koha e UNMIKU-t dhe nuk ka pësuar ndryshim ende. Është e vërtetë se thuhet duhet të mirëtohet vendimi pas pëlqimit të ministrisë, por nëse ne bëjmë shkelje rreth këtij akti ministria përkatëse ka me na e kthye vendimin, ku do kërkoj nga ne brenda 30 dite ta rishqyrtojmë këtë vendim. As në rastin e parë për Stone Castle nuk na ka ndodhur, shpresoj se edhe për këtë nuk do na ndodhë, për vete do isha shumë i kënaqur nëse na e kthejnë sepse do e dimë saktë procedurën. Por nëse shkojmë në ministri për ta kërkuar pëlqimin, ata po na thonë merreni vendimin së pari në kuvend. Kjo lëndë e kompletuar shkon në Ministrinë e Bujqësisë, pastaj kjo ministri e ka një komision të formuar nga shumë ministri të tjera të cilët pastaj dalin në teren për ta verifikuar gjendjen, pastaj ata vendosin a do të japin ose jo pëlqimin për ridestinim. Sa i përket pagesës nuk kemi të drejtë ta heqim nga vendimi, sepse nuk e keni paraparë në kuvend këtë çështje në rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, për këtë klasë ai duhet të paguaj 1.00 € m². Pastaj e cekët që duhet të ceket se për çka po destinohet kjo tokë, e nderuar ke harruar të lexoni nenin nr.4 të vendimit, në këtë nen thuhet: Obligohet pronari që paluajtshmerinë për ndërrim destinim ta shfrytëzoj sipas kërkesës së parashtruar, kërkesa e parashtruar është për ndërtim të shtëpisë, ne në vendim nuk mundemi të dalim jashtë asaj se çka duhet të përmbajë një vendim. Për mua ky vendim është në rregull, nuk jemi duke e shkelur ligjin, nuk e kemi shkelur as herën e parë dhe as tani, ne jemi për këtë punë këtu, por edhe nëse e shkelim askush më shumë se ne si zyre ligjore nuk e ka përgjegjësinë.

Rasim Fazliu – Falënderoj shefin e zyrës ligjore që na ka dhënë këto informata, por nuk pajtohem me atë që thotë se një herë ne duhet kuvendi i komunës të mirëtohet vendimin, pastaj të kërkohej pëlqimi nga ministria. Në udhëzim thuhet qartë se një herë në ministri duhet që të mirëtohet pëlqimi, a është i vjetër apo i ri ky udhëzim nuk e di, por e di që është në fuqi, prandaj çdo udhëzim administrativ që është në fuqi ende nuk mundet të themi është kështu, nuk është kështu, prandaj ja tërhiqi vërejtjen zyrtarit ligjor që mos të thotë më kështu.

Isak Hoti – Së pari sa i përket tërheqjes së vërejtjes, mua ka të drejtë vetëm kryetari i komunës me ma tërheq vërejtjen, askush tjetër sepse atij i përgjigjem. E dyta unë e lexova udhëzimin administrativ dhe e di çka thotë, neni 6 pika 6.2 e cekë: Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore prej kategorisë 1-4, do të bëhet me vendim të kuvendit komunal, pas marrjes së pëlqimit nga ministria. Më parë ju thash se ne kemi qenë në ministri që ta marrim pëlqimin, por ata na thanë se një herë merreni vendimin e pastaj pëlqimin.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërë, e qes në votim aprovimin e vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores për shërbime publike.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, rregullorja për shërbime publike ka një material voluminoz, sot kjo rregullore është si pikë e rendit të ditës, ku kërkohet nga ju që ta jepni dritën jeshile që të shkojë në diskutim publik. Sa i përket kësaj rregullore nuk do isha leshur në debate për arsye se kjo rregullore është ende si draft, por do të jepnit një kontribut të madhe nëse ju të nderuar kuvendar do më dërgonit në email mua ose zyrtarit për informim propozimet, vërejtjet ose ndonjë sugjerim që ka të bëjë me këtë rregullore.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderojmë drejtorin që na ka sjellë këtë draft rregullore, për vete e kam lexuar këtë rregullore dhe me të vërtetë është mjaftë e kompletuar, por mendoj se gjatë rrugëtimit që do të

ketë kjo rregullore ne debate publikë do të plotësohet ende, ne si anëtar të kuvendit pasi të kthehet kjo rregullore nga diskutimi publik në kuvend, do e japim kontributin tonë. Në emër të grupit të PDK-së propozoj që kjo rregullore të dele në diskutim publik.

Afërdita Thaqi – Unë do i përmendi për drejtorin ato anë pozitive, drejtori i shërbimeve publike është njëri nga drejtorët më të përgjegjshëm, më i përgatituri dhe më punëtor. Por në nenin 19 thuhet se qytetarëve do i ndërprejë ujin e pijes dhe shërbimin e marrjes së mbeturinave dhe nëse nuk e paguajnë obligimin, ndërsa ne e dimë këto janë gjërat primare dhe jetike për jetesë, pyetje ime është a kanë të drejtë apo jo.

Munib Durguti – Ne dimë se këtu vetëm kërkohet leje që kjo rregullore të dele në debat publikë, kjo rregullore prapë do të kthehet në kuvend dhe pastaj aty do të jepen propozimet dhe vërejtjet e fundit nga ne. Por i kisha propozuar drejtorit që kjo rregullore ta ketë një kapitull për Qetësi Publike, sepse këtu fare nuk trajtohet, ne pak më parë biseduar me kryetarin rreth këtij problemi. Kishte me qenë mirë që kjo të jetë pjesë e rregullores para se të dele në debat me qytetar, sepse e di që qytetarët janë mjaft të interesuar rreth kësaj pike. Unë do të kontribuojë rreth kësaj rregullore, do bëjë propozime edhe me shkrim, në seancën e radhës.

Fehmi Cena – Edhe ne e kemi lexuar me kujdesë këtë rregullore, mendoj se është një rregullore gjithëpërfshirëse, kisha me thanë me standardë ndërkombëtare, do ndikojë pozitivisht në mirëqenien e të gjithë qytetarëve tanë nëse kjo rregullore do të zbatohet. Mendoj se gjatë debatit kjo rregullore do të ketë edhe plotësime të tjera shtesë, prandaj ne si grupe i LDK-së e përkrahim që kjo rregullore të dele në debat publikë.

Dervish Çadraku – Nuk e shohë të arsyeshme që kjo rregullore të diskutohet sot, pasi që kjo rregullore do të dele në debat publik, prandaj mendoj se kjo rregullore gjatë debatit publikë do të plotësohet me tjera çështje, dhe pasi të përfundojë debati kjo rregullore do të kthehet në kuvend ku pastaj ne do të diskutojmë pak më gjerë. Ne si grup VV-së jemi pro që kjo rregullore të dele në debat publik.

Kryesuesi – E qes në votim marrjen e vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores për shërbime publike: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për mbështetje financiare për Festivalin Tradicional “Festa e vjeljes së rrushit – 7 shtatori”.

Kryetari – Të nderuar festivali i vjelës së rrushit tani më ka një traditë bukur të gjatë, mendoj se kjo është një ngjarje bukur e rëndësishme për komunën tonë. Edhe në këtë vite unë si kryetar i komunës e kam themeluar këshillin organizativ, janë duke u bërë përgatitjet e fundit rreth këtij festivali. Mendoj se përkrahja e komunës si partner serioz dhe si nikoqir të kësaj ngjarje është bukur të rëndësishme, në kodin buxhetor i kemi mjetet e ndarë për këtë festival, ku përbërja e kuvendarëve të kaluar ka vendosur se sa do të jenë ato mjete, jam dakorduar me ekipin time dhe në bazë të kësaj asaj çka ndodhë dhe çka pritët të ndodhë edhe gjatë përgatitjeve, përkrahja jonë financiare pavarësisht që është simbolike dhe jo aq sa duhet ndoshta, por është aq e rëndësishme për mbarëvajtjen e festivalit. Kërkojë nga ju të nderuar aprovimin e shumës financiare të përcaktuar qartë në vendim.

Rasim Fazliu – Ky festival i bënë nderë komunë së Rahovecit, po ashtu ky festival e afirmon komunën e Rahovecit si brenda ashtu edhe jashtë vendit, prandaj gjithsesi se duhet që të mbështesim ne si kuvend komunal këtë propozim vendim. Kam një propozim të nderuar, ndoshta kishte me qenë mirë që këshilli organizues fillimisht për këtë mbledhje të na kishte sjellë një specifikacion, ku do i cekë në një tabelarë se për çka ju nevojiten këto mjete, mendoj se kështu do ishte më e kompletuar. Pastaj pasi të përfundojë festivali prapë këtij kuvendi duhet që ti sjellin një raport se ku janë shpenzuar ato mjete.

Dervish Çadraku – Po ashtu edhe unë mendoj se ky festival është vlerë dhe është në një mënyrë identifikim i Rahovecit me rrushin, Rahoveci është tradicionalisht i lidhur me rrushin dhe provimet që dalin prej tij. Shpresoj dhe uroj që festivali i vjeljes së rrushit të shkojë sa më mirë, por ajo që më intereson mua është a kemi mundësi që të kemi një qasje të drejtpërsëdrejti në këshillin organizativ ne si kuvend komunal, pa dashtë me e fye askënd, por të jemi një farë monitoruesi të këtyre mjeteve, pra të kemi një plan veprimi

se nga do shkojnë paraprakisht këto mjete. Pra nëse kishte me qenë e mundur ne si kuvend të kemi një përfaqësues në këtë këshill, gjithmonë e them nëse kemi të drejtë.

Fehmi Cena – Ne mendojmë se festivali i vjeljes së rrushit “7-Shtatori”, është shumë pozitiv si për qytetin tonë ashtu edhe për komunën, ky festival i jepe kuptimin edhe për nga tradita e vjeljes së rrushit, prandaj ne e përkrahim plotësisht këtë propozim dhe jemi që të fuqizohet sa më tepër ky festival. Po ashtu jam dakord me parafolësit që ky propozim vendim është dashur që të ketë edhe një shkresë shtesë rreth organizimit të festivalit, dhe rreth shpenzimit të buxhetit, sepse mendoj se nuk janë vetëm këto mjete, ata me siguri do të kenë edhe të hyrat e tjera, qoftë nga vetë festivali ose nga donatorë të ndryshëm. Ne si grupe i LDK-së jemi që të përkrahet fuqishëm ky festival.

Kryetar- Zakonisht raporti për shpenzime bëhet pas ngjarjes, por me të drejtë e keni ngritur këtë çështje. Do ju tregoj se çka kam vepruar unë si kryetar komune në këtë drejtim, kam bërë disa ndryshime, i kam bërë 22 vetë i kamë bërë anëtar të këshillit organizativ, kjo ka ndodhur për herë të parë. Pastaj e kam involvuar komunën në këtë këshill me financierë zyrtarë komunalë që janë më e zotë, dua të eliminojë edhe këtë problem sepse ka përfalje shumë se çka është duke ndodhur në këtë festival. Të nderuar gjërat deri më tani kanë shkuar tepër mirë, për herë të parë jemi duke zbatuar rregulloren në fuqi që me ankand të bëhet thirrja se kush do të konkurroj për ti zënë vendet për kafiteri, tarifatat janë të caktuara sipas rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Pra nuk është më këshilli organizativ i cili thotë qiti kaq mjete për të hyrë, por kjo përcaktohet me rregullore. Ndërsa sa i përket gjendjes së si organizohet ky festival, po ju them se ende donë punë për të bërë, në këtë drejtim do të ketë akoma një qasje më serioze, për shkak se me të vërtetë është duke u organizuar mirë, por publiku nuk është se ka shumë informata se çka është duke ndodhur. Hardhë Festi është një OJQ e certifikuar e cila tashmë e ka një përvojë që të organizojë ngjarje dhe evenimente të këtilla, meqenëse është OJQ e cila vepron në Rahovec, ne kërkojmë që të kemi qasje në veprimtarinë e kësaj organizate sidomos kur bëhet fjalë për mjete financiare, kjo është e drejtë ligjore. Janë minimum pesë punëtorë të komunës së Rahovecit që janë pjesë e këtij këshilli dhe kanë mundësi që të kenë sa më shumë informata si për mjetet që i jepe komuna por edhe për mjete që hynë nga aktorët e ndryshëm të cilat marrin pjesë në këtë festival. Këtë e thash për hire të publikut dhe për hir të institucionit sepse ne marrim përgjegjësi për çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm që mundet të bëhet. Kuvendi i komunës për vitin e ardhshëm do të ketë agjendën e të gjitha aktiviteteve e pse jo ndoshta edhe agjendën financiare, para se të ndodhë festivali.

Florije Boshnjaku – E përkrahi këtë propozim vendim dhe është shumë me vend, por sapo dëgjova kryetarin i cili e tha se ata që i vendosin objektet e përkohshme, pagesën të cilën do të bëjnë ata do të shkojnë në të hyrat e komunës, nëse është kështu atëherë kjo është duke u bërë për herë të parë dhe është diçka për tu lavdëruar sepse është shumë me vend.

Besmire Bytyqi – Meqenëse po lavdëroheni, këtë vit ndryshe këtë vit ndryshe, të nderuar Hardh Festi në këtë përmasë është viti i katërt që organizohet, për këtë unë duhet që të falënderoj kryetarin tim z. Idriz Vehapi, i cili i ka dhënë shumë mbështetje këtij festivali deri sa ka qenë kryetar i komunës. Të nderuar falë tij ky festival është këtu ku është sot, ku njihet jo vetëm në Kosovë por në mbarë botën, prandaj juve ju dëshirojmë shumë suksese.

Kryetari – e nderuar unë fjalë të mira i kam për z. Idriz Vehapin, i kam më të mira se tuat, por nëse duhet të falënderohet dikush për këtë festival, atëherë duhet që të falënderohet Ish presidenti i Kosovës z. Ibrahim Rugova, sepse ai i pari e ka nisë këtë punë, kurse është shumë mirë që ky festival është duke mare traditë dhe është duke u pasuruar nga viti në vit, po ashtu është mirë që përballë kësaj ngjarje të jemi seriozë ne si institucione sepse po ashtu jemi edhe nikoqir dhe kemi përgjegjësi.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin për marrje të vendimit për mbështetje financiare për Festivalin Tradicional “Festa e vjeljes së rrushit – 7 shtatori”: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë(6), e rendit të ditës. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:05


Të Nderuar kuvendarë: Për shkak të prishjes së teknikës së incizimit të zërit, nuk është dëgjuar pastër diskutimi i bërë gjatë mbledhjes së kuvendit, kërkojë ndjesë nëse gjatë përpilimit të procesverbalit kam gabuar ndonjë fjali. Ju lutem nëse keni ndonjë vërejtje të më shkruani në emalin tim.

Me respekt Skender Hamza.

01 Nr. 2685

Rahovec, 26.09.2018

Procesmbajtësi


Skender Hamza

